



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 24.08.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.08.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **BERISHA COM SHPK**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –I-rë Lot 3”, me Nr. të Prok: 632-21-574-5-1-1, Nr. Brendshëm 632-21-003-511, nxjerr:

### V E N D I M

**1. Refuzohet** si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim Operatori Ekonomik **BERISHA COM SHPK** e dt.17.08.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –I-rë Lot 3”, me Nr. të Prok: 632-21-574-5-1-1, Nr. Brendshëm 632-21-003-511, kundër **NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 12.08.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .

**2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, e publikuar me datë: 12.08.2021;**

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

## Arsyetim

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 24.08.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1.Pika ankimore:

AK Komuna e Gjakovës, Komisioni për vlerësimin e tenderëve na ka eliminuar si të pa përgjegjshëm kinse nuk kemi prezantuar Sigurimin e Tenderit për 120 ditë por për 90 ditë, ku i njejtë LOT (LOT III) nuk pa pasur fare nevojë për sigurim të tenderit. po më njejtën arsye jemi eliminuar dy herë, Njoftim Mbi vendim I-rë dhe Njoftim mbi Vendim II-të, të bashkangjitura do të gjeni edhe faktet.

Pretendimi i mesiperm qendron pasi që nuk është kërkuar sigurim në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

2.Pika ankimore:

- AK Komuna e Gjakovës ka kërkuar sqarimin e tenderit nga kompania e rekomanduar për dhënie të kontratës në lidhje me Vërtetimin e Atk-së, Vërtetimin e Tatimit në Pronë, Çertifikatën e Gjykatës Ekonomike dhe Sigurimin.

*“ Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të pranohen përmes e-prokurim se dhe ti sjellni fizikisht.*

*Vërejte-Mos sjellja e këtyre dokumenteve të kërkuara në kohë ofertën tuaj e benë jo valide.”*

Kompania Company Murseli Sh.p.k nuk e ka dorëzuar Vërtetimin e Tatimit në Pronë të kërkuar nga AK Komuna e Gjakovës Zyra e Prokurimit, prap AK e shpallin fitues edhe pse është i pa përgjegjshëm.

Pretendimi i mesiperm nuk qendron pasi që me date 11.08.2021 ka ofruar dokumentet e kërkuara:



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

Komuna Kaçanik  
Drejtoria Ekonomi,Financa dhe Zhvillim

Rr.Qamil Ilozi,Kaçanik  
+381 290 380 047  
kk.rks-gov.net/kacanik/

05-430/03-4617/21

12.02.2021

Në bazë të kërkesës së subjektit afarist **Company Murseli SH.P.K.** . që ka selinë në Kaçanik dhe parashtruesit të kërkesës: **Rexhep Murseli** nga Kaçaniku,Drejtoria për Ekonomi,Financa dhe Zhvillim e komunës së Kaçanikut sipas evidences që disponon,lëshon këtë:

#### VËRTETIM

VËRTETOHET, se subjekti afarist **Company Murseli SH.P.K.** që ka selinë në Kaçanik me pronar **Rexhep Murseli** nga Kaçaniku, NUI: **810306010** ,shifra veprimtarisë si aktivitet kryesor është **4313** ç'ka nënkupton: **Testi shpuarjes dhe shpuarja.**

Ka të kryera obligimet ndaj komunës së Kaçanikut duke përfshirë Ngarkesen e Tatimit në Pronë dhe Obligimet e Taksës së ushtrimit të veprimtarisë së Bizneseve.

Çertifikata e aplikuesit lëshohet me kërkesën e tij dhe do ti shërbejë si dëshmi me rastin e aplikimit për Tender.

*Bahri Selimi*  
Drejtore/Drejtorisë



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of  
Komuna e GJAKOVË / Opština ŽAKOVICA /



Dëzuar në nënin 18 të ligjit 03/L-204 për tatimin në pronë, si dhe udhëzimit administrativ nr. 7/2011 të lëshuar nga MF, i cili ka të bëjë me urdhërosat e ndalimit të shërbimeve komunale për dotyrim të pengosës së tatimit në

Na osnovu člana 18, zakona 03/L-204 za porezi na imovinu i administrativne urudbe MF br. 7/2011, u vezi zabrane opštinskih usluga za prinudu uplate poreza na imovinu, izdaje se ova:

Based on the article 18 of LAW 03/L-204 on property tax and administrative instruction MF no. 7/2011 on termination of services for enforcement of the municipal property tax, the municipal Property Tax Office

Nr / Br / No 450-0-381  
20217975

19/03/2021

VËRTETIM  
POTVRDA  
CERTIFICATE

Me të cilin vërtetohet se tatimpaguesi  
Kojim se pothuqje da je poreznik  
that certifies that taxpayer

PJETER QERIMI

GJAKOVË  
Komuna / Opština / Municipality

GJAKOVË BEC  
adresa / adresa / address

I ka kryer pjesërisht / plotësisht obligimet e tatimit në pronë  
Dollmično/ izveršio uplatu poreskih obaveza  
has partially / fulfilled obligations on property tax

MARISA SHPK


Vërtetimi lëshohet në bazë të kërkesës së / Potvrda se izdaje na zahtov / Certificate is issued by

Për nevoja personale  
dho shërben për / I služí za / and is used for

TENDER

Shënime shtesë / Drugo podatko / Additional info

Nerishkrimi / Polpis / Signature



3.Pika ankimore:

- Koncerziumi në fjalë **ka ndërhy në Deklaratat Nën Betim** ku dihet që nuk duhet të ndryshohet dosja e tenderit, ata kanë shtuar edhe nr e prokurimit edhe emrin e projektit.

Pretendimi juaj që ka të bëjë me deklaratën nën betim, është i pa bazuar sepse shtimi i emrit të aktivitetit dhe nr.prokurimit në Deklaratën nën betim nuk përbën shkelje por është vetëm devijim minor neni 59 pika 4 e LPP-së:

*4. (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit;*

4.Pika ankimore:

- Koncerziumi në fjalë **nuk ka arritur të dëshmojë që ka puntorë të mjaftueshëm** për realizimin e projektit. Koncerziumi në fjalë nuk ka arritur t'i paraqesë kontratat e punëtorëve siç janë kërkuar në FDT. Të gjitha këto detyrime dhe kritere obligative.

Pretendimi i mesiperm nuk qendron pasi qe OE ka ofruar listen e punetoreve e kerkuar ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin per kontrate ndersa nuk eshte kerkuar kontrate e punetoreve.

5.Pika ankimore:

- Kompanitë e rekomanduar për dhënie të kontratës Marisa Sh.p.k & Company Murseli Sh.p.k pos stafit që nuk e posedojnë kanë mungesë edhe të makinerive, makinerit të cilat i mungojnë janë:
  - 2 Cilindër apo Rul ngjeshës 7t
  - 1 Grejder
  - Kompanit kanë paraqitur makineri të kompanis Gërlica që nuk ka as Marrëveshje, as Kontrat. Të gjitha këto parregullsi janë "të tolerushme/pranueshme" për Komisionin e Vlerësimit dhe Zyrën e Prokurimit.

Pretendimi i mesiperm nuk qendron pasi qe pas sqarimeve te kerkuara OE ka ofruar Marreveshje me OE Marisa.

6.Pika ankimore:

- Koncerziumi Marisa Sh.p.k & Company Murseli Sh.p.k ka paraqitur Referenca dhe kontrata të kompanis N.SH.T."Victory Com". Referenca të cilat edhe nga kjo kompani janë ende në kontraktim ( të pa përfunduara) dhe po të njejtat kanë marrë vërejtje nga Projektmenaxheri,edhe për këtë po quditem se si AK në këtë rast komisioni vlerësues ka bërë këto shkelje amatoreske duke shpërblyer me kontrat këtë OE i cili ka prezantuar referenca të kompanis tjetër. referenca të vitit 2017,raporte për pagesë etj, andaj ne duam ta dimë se si mund të shpërblehet me kontrate një kompani me referenca të kompanis tjetër.Të bashkangjitura do ti gjeni disa fakte dhe argumente rreth kësaj që po themi. Andaj sa i përket Komisionit Vlerësues nuk e dijmë se a kanë pasur njohuri për Prokurim ose a kanë ndonjë kurs te kryer ne lidhje me e-prokurimin dhe ligjin e prokurimit publik.

Pretendimi i mesiperm nuk qendron pasi qe OE ka ofruar referenca/pranime te puneve ne vlere prej 54000 euro aq sa eshte kerkuar ne dosje te tenderit per liderin

7.Pika ankimore:

- Sa i përket Stafit Profesional tek ING. I Ndërtimtarisë Elnaim Ymeri ka kontratë pune me Murseli Company, e vendimin mbi menaxherin e projektit e autorizion Marisa sh.p.k.

Pretendimi i mesiperm nuk qendron pasi qe per OE lider Marisa ka qene lider dhe nuk ka qene kerkese e dosjes se tenderit se kush duhet te pergadis/leshoje nje vendim te tille per projekt menaxherin

8.Pika ankimore:

- Operatori Ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës kanë paraqitur ofert me çmime abnormalisht të ulëta, si dëshmi do t'i gjeni të bashkangjitura paramasën.

Pretendimi i mesiperm nuk qendron pasi qe oferta e OE nuk e ka tejkaluar vleren e parashikuar te projektit si dhe AK nuk e ka pare qe ka cmime abnormalisht te uleta konform Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët.

9.Pika ankimore:

Pas qasjes sonë në dokumentat e Grupit të OE, AK Komuna e Gjakovës prap kërkon dokumente operatorëve ekonomik për dhënie të kontratës si: Kontratat e punëtorëve, marrëveshje për finisher, kontratë me kompani etj. Të gjitha këto nuk i lejon ligji i prokurimit publik sepse ndryshon përmbajtja e dosjes së tenderit nëse kërkohen të gjitha këto dokumente, ku është e ditur dhe argumentuar që ky grup i operatorëve ekonomik nuk janë të përgjegjshëm.

Pretendimi i mesiperm nuk qendron pasi qe eshte kerkuar sqarime vetem ne pikat qe lejon LPP neni 72 dhe RRUOPP neni 39.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve nga publikimi i kesaj shkrese ne platformen e prokurimit elektronik <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>.**



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës